



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURENCËS

NJOFTIM PËR SHTYP

Në mbledhjen e datës 06.10.2022, Komisioni i Konkurrencës ka marrë në shqyrtim procedurën e monitorimit të zbatimit të Vendimit nr. 693, datë 14.05.2020 “Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon, dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve”.

Në kuadër të zbatimit të Vendimit nr. 693, datë 14.05.2020, FSHF ka depozituar pranë AK informacionet e kërkuara. Nga vlerësimi i informacioneve ka rezultuar se FSHF ka zbatuar të gjitha kushtet dhe detyrimet e vendosura sipas VKK nr. 693, datë 14.05.2020.

Për këto arsye Komisioni i Konkurrencës, me Vendimin nr. 911, datë 06.10.2022, vendosi mbylljen e procedurës së monitorimit në zbatim të Vendimit nr. 693, datë 14.05.2020 “Për konstatimin e abuzimit me pozitën dominuese të Federatës Shqiptare të Futbollit, në lidhje me aktivitetin ekonomik që zhvillon dhe dhënien e kushteve dhe detyrimeve”.

Për më shumë shikoni Vendimin nr. 911, datë 06.10.2022 në: [www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al).